




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20.07.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-06/15
PËR/ZA/TO:	z. Arben Mehmeti, Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Mehmeti,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Nuk ekziston konflikt interesi dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksioneve publike si Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan dhe njëkohësisht Koordinator Regjional për Shitje të Produkteve në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Arben Mehmeti – Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, me numër të protokolit 03-02-726/15, në të cilin ka kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e dy funksioneve publike si Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan dhe njëkohësisht Koordinator Regjional për Shitje të Produkteve në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A.

Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bënë edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë Publik të cilët e kanë obligim zbatimin e këtij Ligji, Në bazë të këtij Ligji pozita e Anëtarit të Kuvendit Komunal hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr. 04/L-051, nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim në ushtrimin e funksionit publik në rastin e ushtrimit të funksioneve të lartpërmendura. Pozita e Koordinatorit Regjional për Shitje të Produkteve në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, nuk konsiderohet funksion menaxherial, e cila do të binte ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, neni 16 (paragrafi1), i cili kufizon zyrtarët e lartë në ushtrimin e funksioneve menaxhuese në Ndërmarrjet Publike. Prandaj ushtrimi i funksioneve të lartpërmendura nuk paraqet konflikt interesi dhe mospajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasysh obligimin për deklarimin rast për rast të interesave lidhur me një vendimmarrje të caktuar, neni 13 paragrafi (1,2,3) i Ligjit Nr.04/L-051.

Me respekt!